



**NJOFTIM PËR MEDIA**

**Tarifat e energjisë elektrike për vitin 2009**

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) në takimin e mbajtur sot me 15 prill 2009, ka aprovuar tarifat e reja të energjisë elektrike që do të zbatohen nga 1 prilli 2009.

Tarifat e reja me pakicë të energjisë elektrike janë llogaritur në bazë të shqyrtimit të kërkesës së KEK-ut dhe të KOSTT-it dhe bazohen në të hyrat e lejuara për këto dy ndërmarrje për vitin 2009. Këto tarifa për të gjitha kategoritë e konsumatorëve, në mesatare janë më të larta për 2.5% nga tarifat e deritanishme.

Gjatë analizës dhe vlerësimit të informatave dhe të dhënave për të hyrat e lejuara të paraqitura në aplikacionin për tarifat e vitit 2009 nga KEK sh.a dhe KOSTT sh.a, ZRRE-ja ka marrë parasysh vetëm kostot e arsyeshme e në të cilat nuk përfshihen subvencionet që u janë dhënë këtyre ndërmarrjeve nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (ku përfshihen subvencionet për import të energjisë, për konsumatorët me nevojë dhe grantet për investime kapitale).

ZRRE me kujdes i ka shqyrtuar aplikacionet për t'i përcaktuar të hyrat e lejuara reale për të dy ndërmarrjet e që janë më të ulëta se ato të kërkuarat, andaj edhe përqindjet e rritjes së tarifave të energjisë elektrike janë më të ulëta se ato të kërkuara.

Bordi i ZRRE-së ka konsideruar se tarifat e reja janë të përballueshme për konsumatorët me të ardhura më të ulëta, nxisin kursimin e energjisë te konsumatorët që shpenzojnë shumë, dhe stimulojnë investimet në sektorin e prodhimit dhe të shërbimeve të energjisë elektrike.

Po ashtu këto tarifa do t'i mundësojnë KEK-ut dhe KOSTT-it të rrisin cilësinë e shërbimeve ndaj konsumatorëve, të zhvillojnë sistemet e tyre duke siguruar një qëndrueshmëri financiare, dhe njëkohësisht do ti nxisin që të jenë më efikas në zvogëlimin e shpenzimeve dhe të humbjeve.

Vendimin në lidhje me tarifat e reja të energjisë elektrike mund ta gjeni në faqen elektronike të ZRRE-së [www.ero-ks.org](http://www.ero-ks.org).